

Njihni të drejtat tuaja: Statusi i qendrimit (ose leja e qendrimit të përhershëm)

Ju keni të drejtë të aplikoni për statusin e përhershëm të qendrimit nëse:

- Keni filluar të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar (MB) nga 31 Dhjetor 2020
 - Keni jetuar në Mbretërinë e Bashkuar vazhdimisht për 5 vjet *
- * Qëndrimi i vazhdueshëm do të thotë që ju nuk keni munguar në MB për më shumë se 6 muaj në një periudhë prej 12 muajsh, për 5 vjet rresht. Ka përjashtime.

Ju do të jeni në gjendje të:

- Punoni në Mbretërinë e Bashkuar
- Perdorni shërbimet e NHS
- Regjistroheni në arsim ose vazhdoni studimet
- Udhëtoni brenda dhe jashtë MB
- Qasje në fondet publike siç janë ndihmat sociale dhe pensionet
- Qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar për sa kohë që dëshironi
- Sillni familjen tuaj për të jetuar në Mbretërinë e Bashkuar

Shtetasit e BE-së me status të përhershëm të qendrimit kanë të njëjtat të drejta si ato para Brexit.

Nëse keni status të përhershëm të qendrimit, ju mund të kaloni deri në 5 vjet me radhë jashtë MB-së pa humbur statusin tuaj.

Nëse jeni një shtetas zviceran, ju dhe anëtarët e familjes suaj mund të kaloni deri në 4 vjet me radhë jashtë Mbretërisë së Bashkuar pa humbur statusin tuaj.

Do t'ju kërkohet të vertëtoni statusin tuaj duke përdorur një "kod" kur përdorni NHS, kur aplikoni për një punë, kur merrni me qira një pronë dhe kur aplikoni për përfitime të ndihmës sociale dhe / ose asistence sociale.

[Linku: faqja zyrtare e Ministrisë së Brendshme ku mund të shihni dhe të vërtetoni statusin tuaj të emigrimit.](#)

[Shiko: video se si të vërtetoni statusin tuaj me një 'kod'](#)

Njihni të drejtat tuaja: Statusi i qendrimit të përkohshëm (ose leja e qendrimit të përkohshëm)

Ju keni të drejtë të aplikoni për status të qendrimit të përkohshëm nëse:

- Filloni të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar nga 31 Dhjetor 2020
- Keni jetuar në MB për më pak se 5 vjet

Me statusin e përkohshëm të qendrimit ju do të mund të:

- Punoni në Mbretërinë e Bashkuar
- Përdorëni NHS-në
- Regjistrohuni për edukim ose të vazhdoni studimet
- Udhëtoni brenda dhe jashtë MB
- Qasje të kufizuar në fondet publike (mund të ndryshojë)
- Sillni disa anëtarë të familjes për të jetuar në Mbretërinë e Bashkuar (mund të ndryshojë)

Ju duhet të aplikoni për statusin e përhershëm të qendrimit pasi të keni jetuar në MB për deri në 5 vjet vazhdimisht.

Me statusin e përkohshëm të qendrimit do të ju duhet 'e drejta për të banua' për të marr ndihma sociale dhe për mirëqenie. Ju nuk do të keni automatikisht 'të drejtën për të banuar' nëse keni status të përkohshëm të qendrimit. Ju duhet të bëni këtë duke vërtetuar se keni një vend pune ose jeni i vetëpunësuar, keni kursime që mund të përdorni, ose jeni student. Do të ju kërkohet të vërtetoni statusin tuaj duke përdorur një "kod" kur të përdorëni NHS, kur aplikoni për punë, kur merrni me qira një pronë dhe kur aplikoni për ndihma sociale ose asistence sociale.

[Linku: faqja zyrtare e Ministrisë së Brendshme ku mund të shihni dhe të vërtetoni statusin tuaj të emigrimit.](#)

[Shiko: video se si të vërtetoni statusin tuaj me një 'kod'](#)